



Alternativa

**RAPORTI I PUNËS SË SUBJEKTIT POLITIK – ALTERNATIVA
(2018 - 2021)**

Mars 2022

Përmbajtja

1. Hyrje	2
2. Aktivitetet e subjektit ALTERNATIVA	2
2.1. Aktivitetet në vitin 2021.....	2
2.2. Aktivitetet në vitin 2020.....	3
2.3. Aktivitetet në vitin 2019.....	3
2.4. Aktivitetet në vitin 2018.....	6
3. Zgjedhjet Qëndrore dhe Lokale (2019 – 2021	7
4. ALTERNATIVA në media.....	8

Hyrje

Që nga themelimi, Alternativa si parti liberal demokratike ka qenë aktive në skenën politike me organizime të ndryshme politike. Edhe gjatë kohës së pandemisë puna ka vazhduar pavarësisht vështirësive të paraqitura.

Edhe ky vit filloi me aktivitetet e Alternativës si: vizita e kryetares Kusari Lila në parlamentin Europian në Strasbourg të Francës ku u zhvillua takimi i VIII i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE – Kosovë; shënimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës me të gjitha degët e Alternativës për të vazhduar me mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të Partisë Alternativa këtu pranverë.

Në këtë raport pasqyrohen disa nga aktivitetet më të rëndësishme të Alternativës të realizuara gjatë periudhës kohore në mes të dy Kuvendeve Zgjedhore.

Në vazhdim gjeni të listuara aktivitetet më të rëndësishme gjatë periudhës kohore katër vjeçare 2018 - 2021.

Aktivitetet në vitin 2021

Më **8 Mars** kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari Lila me bashkëpunëtorët nga dega e Alternativës në Gjakovë, Diana Qarkaxhija dhe Ali Tafarshiku, vizituan pikën grumbulluese të qumështit të znoj. Hatixhe Binaku në fshatin Korenicë të Gjakovës.

Më **10 mars** në zyrën qendrore të Alternativës në Prishtinë u zgjodh Kryesia e re e degës së Prishtinës.

Më **13 Mars** në zyret e Alternativës në Prishtinë u mbajt tryeza me temën, "Prioritetet e ekonomisë së Kosovës dhe sfidat e përballimit të pandemisë" ku të ftuar në Alternativë ishin, drejtori i OEAK, Arian Zeka, Drejtori i KBK, Astrit Panxhaj, Koordinatorja e Forumit Ekonomik të Grave, Saxhide Mustafa dhe drejtori i ICK, Uranik Begu. Nga subjektet politike të koalicionit të Qeverisë së re të Kosovës pjesëmarrëse në tryezë ishin deputetja Yllza Hoti nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Jeta Statovci deputete nga Lista Vjosa.

Më **19 Mars** u mbajt paneli i diskutimit me temën "Energjia dhe Mjedisi në Kosovë, Balanci që Duhet të Mirëmbahet" ku si panelistë ishin të ftuar Luan Shllaku - Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Arben Kllokoqi - Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Egzona N. Shala - Ambientaliste, shoqata Eco – Z dhe Fadil Ismajli - Ndërmarrja e re e Energjisë së Kosovës.

Më **25 Mars** në kuadër të vizitave të muajit Mars tek gratë ndërmarrëse, kryetarja Mimoza Kusari me bashkëpunëtorët nga Alternativa, vizituan komunën e Lipjanit dhe atë të Obiliqit ku mbështeti aktivitetet ekonomike të grave të vyeshme në fushën e bletarisë, shpeztarisë, gatimit të ushqimit tradicional dhe hortikulturës.

Më **26 Mars** në kuadër të tryezave të Alternativës në Gjakovë u diskutua për alternativën e zonës së lirë ekonomike si mundësi e zhvillimit të komunës dhe rajonit, përfshirë komunat fqinje dhe Malësinë e Gjakovës me të ftuarit Albert Baraku, magjistër i ekonomisë dhe ekspert i ndërmarrjeve publike, Leonora Kusari, menaxhere dhe koordinatorë rajonale në BERZH, Fatos Stavileci, inxh. elektroteknikës, ndërmarrës në fushën e TIK-ut dhe Mimoza Kusari – Kryetare e Alternativës dhe deputete e Kuvendit të Kosovës.

Më **1 Prill** Kryetarja e Alternativës dhe deputetja e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari u zgjodh Kryesuese e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

Më **8 Qershor** Kryetarja e Alternativës Mimoza Kusari mori pjesë në panelin e Democracy for Development (D4D) për Rimëkëmbjen Ekonomike.

Më **13 Gusht** u zyrtarizua kandidatura e kryetares së Alternativës, Mimoza Kusari Lila si kandidate e përbashkët me Lëvizjen VETËVENDOSJE për të parën e komunës së Gjakovës.

Aktivitetet në vitin 2020

Më **13 Janar** - është përgaditur programi qeverisës i subjektit liberal demokratik Alternativa i cili u mbështet nga fondacioni Westminster për Demokraci dhe Mbretëria e Bashkuar të cilët gjithashtu kanë krijuar urën e bashkëpunimit në mes të Alternativës dhe partisë së Wellsit, Plaid Cymru.

Më **17 Shkurt** u mbajt edicioni i dytë i forumit Global të Grave Dubai 2020, në Emiratet e Bashkuara Arabe ku mori pjesë kryetarja e Alternativës dhe deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari – Lila.

Më **19 Qershor** kryetarja Mimoza Kusari Lila prezantoi për Balkan Green Foundation në serinë e prezantimeve GreenTalk qëndrimin e saj rreth zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe zhvillimit ekonomik të përhershëm.

Më **15 Dhjetor** - Kryetarja dhe deputetja e Kuvendit të Kosovës Mimoza Kusari Lila morri pjesë në panelin e organizuar nga NDI Kosovo për Javën e Gruas #WOW Kosovo2020

Aktivitetet në vitin 2019

Më **28 Janar** në zyret e Alternativës, Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari Lila dhe nënkryetari Ilir Deda pritën në takim Ambasadorin e SHBA-ve në Kosovë, z. Philip S. Kosnett ku diskutuan lidhur me situatën aktuale në Kosovë, sfidat me të cilat Kosova po ballafaqohet dhe domosdoshmërinë që partitë politike të marrin përgjegjësinë për tejkalimin e sfidave.

Më **5 shkurt** u mbajt debati publik në Pejë me temë diskutimi “Dialogu Kosovë - Serbi dhe bashkësia ndërkombëtare” ku si panelist morrën pjesë Kryetarja Mimoza Kusari Lila – Alternativa dhe Albin Kurti, Kryetar - Lëvizja Vetëvendosje.

Më **9 Shkurt** në Gjakovë, përfaqësuesit e Alternativës Kryetarja Mimoza Kusari Lila dhe Sekretarja Anxhelina Krasniqi, së bashku me antarët e Kryesisë qendrore Hasan Preteni dhe Gurakuq Dobruna, njëherit kryetari degës së Alternativës në Gjakovë, zhvilluan debat publik me qytetarët e Komunës së Gjakovës rreth situatës politike në Republikën e Kosovës.

Në konferencën për media të **16 Shkurtit**, Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari Lila bashkë me dy anëtarët e Kryesisë qendrore, Veton Qipa dhe Alfred Halili, prezantuan qëndrimet e Alternativës dhe kundërshtimet për ligjin e pagave dhe privatizimin e dëmshëm të asetëve strategjike të Kosovës.

Më **22 Shkurt** në Prishtinë, partia Alternativa organizoi për herë të parë Gala Mbrëmje “Pavarsia me Alternativën” me rastin e festës së 11 Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe për fillimin e një praktike të re të ngritjes së fondeve dhe partneritetit me bizneset.

Më **16 Mars** u mbajt konferenca për media nga Kryetarja Mimoza Kusari dhe nën Kryetari Reshat Nurboja të Alternativës lidhur me zhvillimet e fundit politike në vend dhe mungesën e përgjegjësi të pushtetit të atëhershëm.

Më **20 Mars** Alternativa organizoi panelin e diskutimit me temën “Shëndeti dhe Mirëqenia e Vajzave” ku si paneliste ishin të ftuara Dr. Fetije Këpusken, Dr. Anisa Shala dhe Psiko-terapistja Saranda Rexha. Gjatë këtij event, krahas temës së zhvillimit dhe sfidave të vajzave u trajtua edhe çështja e humbjes së besimit në institucionet për të ngritur tema të cilat trajtohen si sociale e jo politike.

Nga data **26 - 30 Mars** pjesëmarrësit nga Alternativa Mimoza Kusari Lila Kryetare e partisë, Angjelina Krasniqi Sekretarja e partisë, Gent Konjuhi Kryetari i Forumit Rinor dhe Hana Zeka, anëtarja e Kryesisë Qendrore dhe Asambleiste në Kuvendin Komunal Gjakovë patën rastin të udhëtojnë në kryeqytetin e Wales, Cardif dhe në Londër ku u takuan me liderë të ndryshëm atje si kryesuesen e kuvendit znj. Ann Jones, liderë të partisë politike Palid Cymru, ministren e kabinetit të qeverisë në hije Leanne Woods ku u bisedua në lidhje me politikat e mjedisit të

pastër, ekonomisë së gjelbërt, rolin e grave në politikë si dhe praktikën e vendeve të ndryshme që udhëhiqen nga gratë dhe japin shembull konkret të politikbërjes së mirëfilltë.

Më **27 Mars** Kryetarja e Alternativës Mimoza Kusari ishte paneliste në javën e gruas në Prishtinë ku u theksua se barazia më shoqëri dhe mundësitë e barabarta janë boshti i politikbërjes së Alternativës.

Në tryezën e datës **4 Prill** ku temë e diskutimit ishte “Balancimi në mes ngritjes në karrierë dhe jetës private” u fol për barazinë dhe gjithëpërfshirjen në vendimarrje dhe në tregun e punës me gratë dhe vajzat mysafire dhe folëset Lule Demoli nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Dita Dobranja, hulumtuese e lartë në Institutin Riinvest.

Më datën **13 Prill** Alternativa mbajti konferencën javore për media me folës Gurakuq Dobruna, anëtar i Kryesisë qendrore dhe kryetar i Degës së Alternativës në Gjakovë dhe Dr. Basri Komoni anëtar dhe asambleistë në KK. në Gjakovë ku u diskutua rreth sistemit të shëndetësisë në Kosovë. Poashtu gjatë muajit Prill u mbajt konferenca për media nga Diana Qarkagjiu e cila foli rreth ngecjeve në sistemin e arsimit.

Nga **16 Prill** Kuvendi i Kosovës ka edhe grupin e deputetëve të gjelbërt GDGJ. Kryetarja e Alternativës dhe deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari me iniciativën e së cilës u formua ky grup, u zgjodh Kryesuese e grupit jo formal të deputetëve të gjelbërt.

Më **20 Prill** u mbajt Konferenca Javore e Alternativës me temën “Gjenda e Mjedisit në Kosovë dhe Alternativat e Alternativës” e prezantuar nga Flutra Bektashi dhe Hana Zeka, anëtare të Komisionit për mjedis.

Më **2 Maj** Alternativa në kuadër të forumeve me mysafirë folës, nutricionistja Diola Dosti Baftiu e cila foli për rolin e ushqimit organik, ndikimin e ushqimit tek adoleshenca e parakohshme, ushqimet e modifikuara gjenetiksht dhe shumë aspekte tjera të verifikimit të ushqimit që konsumojmë çdo ditë.

Më **11 Maj** Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari Lila bashkë me përfaqësues tjerë të opozitës në Kuvendin e Kosovës, u takuan me Kongresistin Amerikan z. Ed Case, me të cilin biseduan për situatën aktuale politike në Kosovë, bashkëpunimin rajonal dhe raportet bilaterale Kosovë - SHBA.

Më **14 maj** Kryetarja e Alternativës Mimoza Kusari morri pjesë në vizitën studimore në Ljubljana, Slloveni të organizuar nga GIZ dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike bashkë me parlamentarët tjerë nga Ballkani. Qëllimi i vizitës është ndarja e përvojave të zbatuara në planet e mobilitetit urban në komunat sllovene.

Më **21 Maj** me organizimin e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Koalicionit për të drejta të barabarta për të gjithë- #ERAC (Equal Rights for All Coalition), Kryetarja e Alternativës dhe deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari Lila morri pjesë në panelin: Gratë në biznes.

Më **8 Qershor** u mbajt edicioni i pestë i Forumit për Qytetet Globale që u mbajt në Chicago, SHBA me temën “Kur gratë udhëheqin” ku Kryetarja Mimoza Kusari Lila prezantoi vështrimet e saj për përvotat e grave në garën politike në Kosovë dhe Ballkan.

Më **6 korrik** u mbajt konferenca për media ku u diskutua rreth keqpërdorimeve të buxhetit të shtetit.

Më **datën 16 Korrik** në programin e Partneritetit për Demokraci të Kongresit Amerikan, Kryetarja Mimoza Kusari Lila prezantoi Kosovën në emër të delegacionit Kosovar.

Më **17 dhe 18 Korrik** u mbajt Forumi i parë i Liderit i organizuar nga Programi për Partneritetin e Demokracisë të Kongresit Amerikan dhe NDI ku Kryetarja Mimoza Kusari Lila prezantoi Kosovën dhe tregoi për sfidat aktuale të atëhershme të demokracisë në Kosovë.

Me datën **13 Nëntor** Kryetarja Mimoza Kusari Lila morri pjesë si paneliste në panelin e diskutimit “Marrja e përgjegjësisë për sundimin e ligjit në Kosovë: qeverisja e mirë në shtetin e porsalindur” të organizuar në Bruksel nga Vocal Europe në bashkëpunim me Misionin e Përhershëm të Portugalisë në BE.

Aktivitetet në vitin 2018

Më **10 Shkurt** u mbajt Kuvendi i Parë Zgjedhor i Alternativës.

Më **8 deri më 10 Mars** 32 anëtare të Forumeve Rinore të Alternativës janë certifikuar nga trajnimi për Ndërtimin Institucional dhe Komunikimin Politik, të organizuar nga Westminster Foundation for Democracy.

Në **Mars** Anëtarët e Alternativës, Emir Balje dhe Adrian Çoça, kanë përfaqësuar subjektin e tyre në Akademinë Liberale Regjionale Politike në Sarajevë dhe në Bruksel të mbajtur nga Centre Party International në bashkëpunim me Fondacionin Boris Divkovic dhe Forumin Liberal Europian.

Më **9 Maj** Kryetarja e Alternativës znj. Kusari Lila ka marrë pjesë në Forumin “Violence is Not the Cost” në SHBA organizuar nga NDI ku ishte edhe paneliste bashkë me ish-Sekretaren e Shtetit, znj. Madeline K. Albright.

Më **2 dhe 3 Qershor** u mbajt një tjetër organizim i NDI, ku kryetarja Kusari Lila ishte edhe pjesë e panelit Forumi për Leadership Rajonal i mbajtur në Mavrovë të Maqedonisë në të cilin u trajtua pozita e grave dhe rinisë në vendimmarrjen politike.

Në një takim me kryetarin e Prishtinës z. Shpend Ahmeti më **14 Qershor** është zyrtarizuar bashkëqeverisja e Alternativës në Komunën e Prishtinës me udhëheqjen e Drejtorisë për Mirëqenje Sociale.

Më **20 Qershor**, Alternativa mbajti Konventën Qëndrore të partisë ku me shumicë votash unanime u zgjodh kryetari i forumit rinor z. Gent Konjuhi si dhe kryesia në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarësh.

Kryetarja e Alternativës znj. Kusari Lila gjatë vitit 2018 pati takime me degët e Alternativës në Gjiilan e Vushtri për të biseduar për çështjet që i preokupojnë.

Në **Gusht** është zhvilluar takimi i deputetëve të Alternativës me Ambasadorin e SHBA-ve në Kosovë, z. Greg Delawie, në të cilin ata prezentuan qëndrimet e Alternativës në lidhje me dialogun me Serbinë dhe kundërshtuan projektin e ndryshimit të kufijve.

Më **12 Shtator** përfaqësues nga kryesia e Alternativës qëndruan në Bujanovc për një takim shumë miqësor me liderë shqiptar atje me c’rast u bisedua rreth prioritizimit të çështjes së Luginës së Preshevës në bisedimet Kosovë – Serbi, parimin e reciprocitetit dhe intensifikimin e komunikimit.

Më **14 Shtator** krerët e Alternativës zhvilluan një takim shumë përmbajtësor me Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, z. Ditmir Bushati me të cilin biseduan rreth situatës aktuale në Kosovë duke kundërshtuar fuqishëm cfarëdo ndryshimi kufinjsh si dhe rikonfirmuan rëndësinë e koordinimit me Tiranën.

Më **24 Shtator** znj. Kusari Lila në cilësinë e udhëheqëses së grupit parlamentar të miqësisë Kosovë – Kanadë bashkë me homologen e saj në Parlamentin Kanadez znj. Anita Vandenbeld nënshkruan në Otawa, deklaratën e përbashkët për thellimin e bashkëpunimit dhe intensifikimit të raporteve bilaterale të dy vendeve.

Zgjedhjet Qëndrore dhe Lokale (2019 - 2021)

Megjithëse parti e re, Alternativa shënoi suksese në dy zgjedhje parlamentare me rradhë, më 2019 dhe 2021, duke siguruar nga një ulëse në parlament, në kuadër të Lëvizjes Vetëvendosje.

Alternativa luajti rol kyç në ndryshimin e nisur në vitin 2019 dhe të vulosur në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021 në Republikën e Kosovës, ku për herë të parë u arrit që një subjekt politik të marrë më shumë se 50% të votave.

Zgjedhjet Qëndrore 2019 dhe 2021			
Viti	Kandidati	Votat	Ulëset
2021	Mimoza Kusari Lila	53.618	1
	Ali Tafarshiku	3.289	
	Angjelina Krasniqi	3.163	
2019	Mimoza Kusari Lila	22.131	1
	Reshat Nurboja	2.153	

Vitin që lam pas, Partia Alternativa poashtu ka kandiduar në zgjedhjet lokale me Mimoza Kusari Lilën për postin e kryetarës së Gjakovës, sipas marrëveshjes së bashku me Lëvizjen Vetëvendosje dhe për Asamble të Kuvendeve Komunale në gjithsej shtatë komuna të Kosovës me kandidatët për:

Gjakovë: Agon Dobruna, Diana Qarkagjia, Ali Tafarshiku, Diana Maloku Xërxa, Basri Komoni, Kaltrina Milici, Don Dobruna, Lirim Bicurri, Vlora Bakalli Komoni, Hysen Berisha, Lazër Nrejaj, Hasan Krasniqi, Nesrete Nuka, Sevdije Haxhibeqiri;

Prishtinë: Zejnedin Baxhaku dhe Sibora Kadriu;

Vushtrri: Doruntina Mulaku Januzi dhe Hilmi Hajra;

Prizren: Ejona Hoxhaj;

Pejë: Agron Myftari, Afërdita Kastrati, Albion Studenica, Linda Çavdarbasha, Adnan Gjakova, Angjelina Krasniqi, Xhevdet Belegu;

Gjilan: Sebahate Kurti Arifi;

Mitrovicë: Mehmet Mehmeti;

Alternativa numëron tre asambleistë në Kuvendin Komunal të Gjakovës, nën siglën e Lëvizjes Vetëvendosje.

ALTERNATIVA në media

Vizibiliteti në media është pjesë e rëndësishme e aktivitetit politik. Alternativa gjithmonë ka qenë e hapur për media dhe paraqitja e saj është gjithnjë në rritje.

Si sfidë në paraqitjen publike, ka qenë identifikimi i Alternativës vetëm me prezencën e kryetares në media, andaj në të ardhëmen duhet të kemi përfshirje më gjërë të figurave të Alternativës në paraqitjet publike dhe në media.

Strukturat e subjektit duke filluar nga degët që trajtojnë problemet lokale, antarët dhe ekspertët në nivelin qëndror që trajtojnë zhvillimet politike dhe temat profesionale si dhe përcjellja e aktualiteteve, reagimet, komunikatat e aktiviteteve, konferencat për media, mesazhet dhe prezenca në rrjetet sociale, duhet të jenë n% focus të strukturave të reja të Alternativës.